



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 82 Datë 24.12.2021

Për Emerim Rruge

Mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, germa m, me kerkese te Njesise Administrative Lure me Nr. 1199 prot date 09.04.2021 dhe me relacionin e komisionit te perhershem te keshillit Bashkiak me date 03.12.2021 : **Komisioni I rendit publik, mbrojtjes civile dhe vlersimit të figurave të shquara të qytetit** ;i paraqet Këshillit Bashkiak ne rendin e dites në mbledhjen e rradhës miratimin per Emerimin e Rruges per te ndjerin Z. Artan Cuku. Keshilli ne mbledhjen e tij, datë 24.12.2021 miratoi unanimisht per :

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për emërtim rruge “Artan Cuku (pas vdekjes) Dëshmor i Atdheut ”Rruga fillon tek kryqezimi I rruges Nazmi Rushit me rrugen Elez Isufi e vazhdon drejt Muzeut – Shkallet e Kamenit deri tek bashkimi I Unazes se Vogel prane Pallatit te Kultures.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori I arsimit dhe Kultures dhe Turizmit
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

RELACION

“ Mbi emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Dibër”

Në kuadër të 109 vjetorit të Policisë së Shtetit në datë 13 Janar 2022, duam të sjellim në vëmendje punonjësin e Policisë së Shtetit që është shpallur « Dëshmorë të Atdheut ». Në shenjë ndërtimi për këtë dëshmorë të Atdheut bazuar në nenin 9 pika 1, nënpika 1.7 shkronja « b », neni 54 shkronja « ll », të ligjit 139/2015 » Për vetëqeverisjen vendore , neni 3 të ligjit 9270, datë 29.7.2004 « Për sitemimin e adresave », të ndryshuar si dhe neni 15 te ligjit nr.109/2018 « Për statusin e dëshmorit të Atdheut, kërkojmë emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve shkollore dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Dibër me emrat e këtyre dëshmorëve të Atdheut.

Propozimi është si mëposhtë :

1. Artan Cuku shpallur « Dëshmor i Atdheut », propozojmë emërtimin e rrugës me emrin e tij. Rruga fillon tek kryqëzimi i rrugës Nazmi Rrushiti me rrugën Elez Isufi e vazhdon drejt Muzeut – Shkallët e Kamenit deri tek bashkimi i Unazës së Vogël pranë Pallatit të Kulturës.

Bashkangjitur keni hartën me planvendosjen e rrugës.

KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË

Shkëlqim MURRJA



